

VENDIM
Nr. 697, datë 6.8.2015

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE, NGA QEVERIA SHQIPTARE PËR
QEVERINË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, PËR LEHTËSIMIN E PASOJAVE
TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA PËRMBYTJET NË GUSHT 2015, NË TETOVË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare, nga qeveria shqiptare, për qeverinë e Republikës së Maqedonisë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) euro, për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet në gusht 2015, në Tetovë.

2. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, në programin buxhetor 01120 "Mbështetje diplomatike jashtë shtetit", shpenzime korrente, t'i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) eurosh, për t'u përdorur si ndihmë financaire për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet e muajit gusht 2015, në Tetovë.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama